

VENDIM
Nr. 115, datë 15.2.2017

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 99.7 HA NË OBJEKTIN “ZALOSHNIJE”, TË QARKUT BERAT, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “ZALOSHNIJA FIORENTINA”, SH.P.K. PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT QËLQEROR TË MERMERIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 99.7 ha, që shtrihet në ngastrat nr.10 e 15 të ekonomisë pyjore “Devri-Terovë” dhe në ngastrat nr.4, 5 e 6, të ekonomisë kullorore “Tomorricë”, në objektin “Zaloshnje”, në qarkun e Beratit, e cila do të përdoret nga shoqëria “Zaloshnja Fiorentina”, sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror të mermerizuar, të hiqet nga fondi pyjor dhe kulloror publik, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore e kullorore, në sipërfaqen objekt minerar, paguhen nga shoqëria “Zaloshnja Fiorentina”, sh.p.k., në bazë të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Zaloshnja Fiorentina”, sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet që përdor sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda tre viteve të para, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe pyjore prej 163.2 ha dhe të përmirësojë një sipërfaqe kullorore prej 45.3 ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Bashkinë Çorovodë.

4. Bashkia Çorovodë dhe shoqëria “Zaloshnja Fiorentina”, sh.p.k. nënshkruajnë marrëveshje jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektet e miratuara, dërgohet në Ministrinë e Mjedisit jo më vonë se 10 ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqja pyjore dhe kullorore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullorore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore dhe kullorore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Çorovodë dhe shoqëria “Zaloshnja Fiorentina”, sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA
FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA "ZALOSHINJA FIORENTINA" sh.p.k. në qarkun e BERATIT**

QARKU BERAT

Lidhja 1

ID Prones	Ekon.Pyjore/Kullos ore	Ngastra	Perdorimi territorit	Administrimi	Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)
BR20 00 010	EP Devri-Terove	10	trungishte	Bashkia Çorovode	19.2
BR20 00 015	EP Devri-Terove	15	trungishte	Bashkia Çorovode	35.2
BR15 00 004	EK Tomorrice	4	kullote	Bashkia Çorovode	15.7
BR15 00 005	EK Tomorrice	5	kullote	Bashkia Çorovode	28.4
BR15 00 006	EK Tomorrice	6	kullote	Bashkia Çorovode	1.2
GJITHSEJ					99.7

